

20101713704

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË ETYRUESHËM**  
**PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonise“ numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009 dhe 50/10) në nenin 3 pika 13 nënpika a) ndryshohet si vijon:

"në pesë vitet e fundit:

- nuk ka pasur interes material ose marrëdhënie afariste me shoqërinë si partner afarist ose si person udhëheqës, anetar i këshillit drejtues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës në partnerin afarist të shoqërisë ose

- nuk ka qenë i punësuar, nuk është anëtar i këshillit drejtues ose anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.

Në pikën 14 pas fjalës: "informim" presja dhe fjalët: „para botimit, distribuimit ose publikimit të tij në mjetet e informimit publik" shlyhen.

Neni 2

Në nenin 20 paragrafi (1) pika v) fjalët: „kapitali personal“ zëvendësohen me fjalën: "kryegjēja".

Neni 3

Në nenin 53 paragrafët (6), (7) dhe (8) shlyhen.

Paragrafi (9) bëhet paragraf (6).

Neni 4

Pas nenit 53 shtohen dy nene të reja 53-a dhe 53-b, si vijojne:

"Neni 53-a

(1) Nese gjatë kryerjes së kontrollit personi i autorizuar për kontroll konstaton se për herë të parë janë bërë parregullsi nga nenet 21-a paragrafët (3), (4) dhe (5), 75 paragrafi (4), 77 paragrafi (7) dhe 96 të këtij ligji, obligohet që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer, me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej 15 ditësh nga sugjerimi dhe me dorezim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është konstatuar parregullsia.

(2) Formen dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe menyren e realizimit të edukimit e përcakton Agjencia.

(3) Edukimin e organizon dhe e realizon Agjencia, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së kontrollit.

(4) Edukimi mund të realizohet për më tepër parregullsi të njëjta ose të ngjashme të konstatuara për një ose për më teper subjekte.

(5) Nese në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nese personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe të njëjtin e mbaron, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e konstatuar.

(7) Nese personi i autorizuar për kontroll gjatë kryerjes së kontrollit konstaton se janë mënjeluar parregullsitë e percaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e kontrollit.

(8) Nese personi i autorizuar për kontroll gjatë kryerjes së kontrollit konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, parashtron kerkese për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në organin kompetent.

(9) Agjencia mban evidencë për edukimin realizuar në menyre të përcaktuar nga Agjencia.

#### Neni 53-b

(1) Në pajtim me nenin 53 paragrafi (5) të këtij ligji shoqëria pensionale, ruajtësi i pronës, menaxheri i huaj i mjeteve apo siguruesi, detyrohen që në afatin e caktuar t'i menjanojnë paligjshmëritë dhe të dërgojnë njoftim në Agjenci për paligjshmëritë e mënjanuara me prova të bashkëngjitura se paligjshmëritë janë mënjanuar ose korigjuar. Nese shoqëria pensionale nuk i mënjanon paligjshmëritë, Agjencia mund ta heqë lejen për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe/ose vullnetare të asaj shoqërie.

(2) Nese Agjencia gjatë kryerjes së kontrollit në punën e shoqërisë pensionale dhe menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme dhe/ose vullnetare, konstaton se ekzistojnë punë ose vepra të cilat janë të dënueshme sipas ligjit, drejtori ose personi i autorizuar prej tij parashtron fletëparaqitje për ngritjen e procedurës në organin kompetent.

(3) Procedura kundërvajtëse nuk mund të ngritet e as të mbahet nëse kanë kaluar më tepër se tre vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja. Parashkrimi i ngritjes dhe mbajtjes së procedurës kundërvajtëse në çdo rast ndodh pas kalimit të pesë viteve nga dita e kryerjes së kundërvajtjes."

#### Neni 5

Në nenin 75 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

„Shoqëria e cila menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional obligohet që ta dërgojë në Agjenci, në fotokopje ose në medium të jashtëm përkatës, materialin e shpallur për marketing në afat prej tri ditësh pas shpalljes së tij. Agjencia miraton udhëzime për përmbajtjen e reklamave dhe për materialin tjetër për marketing të fondeve të detyrueshme pensionale dhe shoqërive të cilat menaxhojnë me to."

Në paragrafin (5) fjalët: "ose ta prolongojë shpalljen e tij" zëvendësohen me fjalët: " shpalljen e mëtutjeshme".

#### Neni 6

Neni 76 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale mund të kryejë punë marketingu të fondit të detyrueshëm pensional në lokalet e veta dhe në lokalet e bashkëpunëtorëve të tij afaristë për marketing. Lokali duhet t'i përmbush kushtet vijuese:

a) të ketë së paku një agjent;

b) të ketë person përgjegjës për kryerjen e punëve të marketingut të shoqërisë që menaxhon me fondin e detyrueshem pensional, i cili mund të jetë i punësuar te bashkepunetori afarist dhe

v) t'i sigurojë hapësirë adekuate për kryerjen e punëve të marketingut, shoqërisë e cila menaxhon me fondin e detyrueshem pensional.

(2) Bashkepunetor afarist për marketing nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të jetë banka ose shoqëria për sigurim.

(3) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare është përgjegjëse për përmbushjen e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare në ditën e fundit të punës së tremujorit, dërgon në Agjenci listë të lokaleve të bashkëpunëtorëve afaristë për marketing, e cila krahas emrit i përmban adresën dhe personin përgjegjës."

#### Neni 7

Në nenin 79 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Ndalohet personi me autorizime dhe përgjegjësi të posacme që të punësuarit t'ia reklamojë fondin e detyrueshëm pensional."

#### Neni 8

Në nenin 105 paragrafi (1) pika a) pas fjalës: "kamatë" vihet pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Pika e) ndryshohet si vijon:

„obligacionet e lëshuara në bazë të lejes nga Komisioni për Letra me Vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe që kuotojnë në tregun zyrtar të bursës së letrave afatgjate me vlere ose në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë që e kontrollon Komisioni, të lëshuara nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe nga shoqëritë aksionare vendore të cilat nuk janë banka;"

#### Neni 9

Në nenin 106 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në letra me vlerë për emetuesin e njëjtë, më së shumti deri në 10% nga vlera nominale e letrës së veçantë me vlerë të emetuar nga ai emetues. Me përjashtim, në obligacionet dhe letrat tjera debitore me vlerë të lëshuara nga njesite e vetadministrimit lokal dhe nga shoqëritë aksionare vendore, mund të investohen më së shumti deri në 20% nga vlera nominale e letrës së veçantë me vlerë të emetuar nga emetuesit. Mjetet e fondit të detyrueshëm pensional nuk mund të investohen në më shumë se 40% nga obligacionet e përgjithshme të emetuara të njësisë së vetadministrimit lokal. Në obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të emetuara ose për të cilat garanton Republika e Maqedonisë ose ndonjeri nga shtetet-anëtare të UE-së ose të OECD-së mund të investohet pa kufizim."

Në paragrafin (2) shtohet fjali e re si vijon: "Me përjashtim, në pjesëmarrjet dhe aksionet e fondeve investuese të emetuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim nga shteti-anetar i UE-së ose OECD-së, mund të investohen më së shumti 15% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, me ç'rast në fondin e veçantë investues mund të investohen më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional."

#### Neni 10

Në nenin 107 pika g) pikëpresja zëvendësohet me pikë dhe shtohet fjalia e re si vijon: "Në kuadër të këtij kufizimi më së shumti 10% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, mund të investohen në obligacione të emetuara nga njësitë e vetadministrimit lokal."

#### Neni 11

Në nenin 134 paragrafi (1) shtohet pika e re 8-a, si vijon:

"8-a) nëse nuk i përmbush kushtet nga neni 76 paragrafi (1) i këtij ligji;"

#### Neni 12

Në nenin 135-a paragrafi (1) pika 1 ndryshohet si vijon:

"nese nuk vepron në pajtim me nenin 75 paragrafi (4) të këtij ligji;"

#### Neni 13

Neni 67 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 50/10) ndryshohet si vijon:

"(1) Agjencia e hap llogarinë në bankën afariste më 3 janar 2011.

(2) Në ditën e hapjes së llogarisë nga paragrafi (1) i këtij neni, 15% e mjeteve të Agjencisë nga llogaria e cila mbahet në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë barten në llogari në bankën afariste, kurse 85% e mjeteve barten në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë."

#### Neni 14

Aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 15

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

#### Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.